



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 4851/1 prot.

Tiranë, më 8.1.2024

**Lënda:** Kthim përgjigjeje kërkesës suaj datë 29.12.2023

**ZNJ. R D RR**

Të dhëna kontakti: Tel:

E nderuar znj. **D Rr**,

Në përgjigje të kërkesës suaj dërguar nëpërmjet postës elektronike në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili në datën 29.12.2023 ia përcolli këtë kërkesë për trajtim Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe protokolluar me tonën me nr. 4851 prot., ju informojmë si më poshtë:

Lidhur me pyetjen e parë, Komisioni raporton se ka marrë vendim për shkarkim nga detyra për 102 subjekte rivlerësimi me funksion prokuror, nga të cilët 45 kanë marrë formë të prerë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (KPA), ndërsa pjesa tjetër është në shqyrtim nga shkalla e dytë e vettingut.

Sa i takon pyetjes së dytë, Komisioni, ose shkalla e parë e vettingut, nga fillimi i procesit ka dhënë vendim të ndërmjetëm për pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës për 5 prokurorë gjithsej, nga të cilët:

- 1 prokuror është pezulluar nga KPK dhe pas ankimit, është konfirmuar në detyrë me vendim të formës nga KPA në vitin 2020;
- 1 prokuror i pezulluar nga KPK në vitin 2023 është në pritje të vendimit përfundimtar pas përfundimit të trajnimit të detyrueshëm nga Shkolla e Magjistraturës.
- 3 prokurorë të tjerë pas periudhës së pezullimit dhe trajnimit të detyrueshëm në Shkollën e Magjistraturës, janë konfirmuar në detyrë nga KPK me vendim përfundimtar.

Në lidhje me pyetjen tuaj të fundit, ju informojmë se numri i prokurorëve që ka dhënë dorëheqjen është 29 gjithsej.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

